



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr. 1052/3 prot.

Tiranë më 22.05.2026

Lënda: Kthim përgjigje shkresës tuaj mbi komentet e reflektuara për projektligjin “*Për censin e bujqësisë*”

MINISTRISË SË BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Tiranë

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “*Zyra e Komisionerit*”) ka administruar shkresën tuaj me nr. 2667/8 prot., datë 19.05.2026, protokolluar me tonën me nr. 1052/2 prot., datë 19.05.2026, me anë të së cilës përcillni reflektimin e komenteve dhe sugjerimeve të dhëna nga Zyra e Komisionerit mbi projektligjin “*Për censin e bujqësisë*”.

Nga shqyrtimi i përmbajtjes së kthim përgjigjes suaj, sa i përket komenteve dhe sugjerimeve të Zyrës së Komisionerit dërguar nëpërmjet shkresës nr. 1052/1 prot., datë 24.04.2026, konstatojmë se nga ana juaj janë marrë në konsideratë për t’u reflektuar në projektligj.

Në këtë kuadër me reflektimin e sa më sipër, Zyra e Komisionerit e vlerëson projektaktin të hartuar konform legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Ndërkohë, kërkojmë nga ana juaj dërgimin e draftit ligjor të bashkërenduar, pasi nuk është bashkëlidhur në shkresën tuaj.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi